



KRYETARI I KOMUNËS

01-Nr-111-71287

ME DATE 15.10.2019

SHPALLJE PUBLIKE

Per angazhimin e punëtorëve me kontratë për punë dhe detyra specifike
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Komuna e Suharekës duke u bazuar në nenin 10 alinea 2 pika 2.3 të ligjit të punës Nr.03/L-212 si dhe bazuar në kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Administratë, përmes Kontrates për punë dhe detyra specifike kërkon angazhimin e punëtorëve për kryerjen e punëve për nevojat e kësaj Drejtorie.

I.Drejtoria për Administratë: Kërkon katër (4) Sigurim fizik të objekteve të Komunës (Rojtar)-

Kohëzgjatja e kontratës 120 (njëqind e njëzetë) ditë.

Paga: 280 Euro Bruto

Kualifikimi : Shkolla e mesme

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1.Bëni sigurimin fizik të godinave dhe hapsirave (oborrit) të Komunës
- 2.Pret dhe informon vizitorët e Komunës pas orarit të punës
3. Ndaloni hyrjen e personave të pa autorizuar dhe të pa dëshiruar;
4. Bëni mirëmbajtjen, kontrollin, pastrimin e oborrit nga mbeturinat, ujë kopshtet barin, kontrollon dritat dhe merr masat për mbrojtjen e objekteve nga fatkeqësitë natyrore (uji, zjarri etj)
5. Kryen punë të tjera shtesë me kërkesë të shefit -Drejtorit.

Aftësitë kryesore, dituria, zotësia që kërkohet:

- Të jete person me integritet te larte personal dhe moral;
- Aftësi të mira komunikimi ;
- Njohuri të mira të punës;

Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin një biografi profesionale (CV), certifikatën që ndaj tij-saj nuk janë duke u zhvilluar hetimet, kopja e letërnjoftimit kopjet e dokumentacionit për kualifikimin. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse të Komunës së Suharekës.

Shpallja mbetet e hapur 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe Web faqen e Komunës së Suharekës.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, ndërsa ata të cilët nuk hyjnë në përzgjedhje nuk do të kontaktohen.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë , duhet të sjellin për verifikim të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen.

Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët e interesuar.

Kryetari i Komunës

Bali Muharemaj

